



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIMIT
SHKOLLA E MESME PROFESIONALE “ANTONI ATHANAS “ SARANDË

Nr. __127/1__ Prot

Sarandë më: 28/08/23

Lënda : Njoftim për lëvizje paralele.

Drejtuar: Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse

Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun

Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

Tiranë

Në zbatim të Ligjit 7961 date 12/07/1995 “ Kodi I Punes ne Republiken e Shqiperise , ligjit Nr. 15/2019 “Për nxitjen e Punësimit”, Ligjit nr. 15 datë 16/02/2017 “Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 554, datë 31.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funkcionit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, të Udhëzimit nr. 14, datë 27.05.2021, “Për Mënyrën e Organizimit dhe Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional, si dhe Aspektet e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore , Përbërjes së Njesisë së Zhvillimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional dhe Zhvillimit të Vazhduar Profesional të Personelit”, “ Shkolla e Mesme Profesionale : “Antonio Athanas”, Sarandë , ju njofton për krijimin e një vend të lirë pune , në pozicionin “_”_Pergjegjes Sektori Finance - Administrim_” . Aplikanti duhet të përmbushë këto kritere:

1. Kritere të përgjithshme:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

2. Kritere të posaçme për përgjegjësi e sektorit të burimeve njerëzore dhe informacionit

- a) të ketë nivelin arsimor master shkencor në fushën e shkencave shoqërore/juridike. Diploma e nivelit Bachelor duhet të jetë në të njëjtën fushë;

b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të ngjashme, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Kritere të posaçme për përgjegjësin e sektorit të menaxhimit financiar dhe aseteve:

a) të ketë nivelin arsimor master shkencor në shkencë ekonomike. Diploma e nivelit *Bachelor* duhet të jetë në të njëjtën fushë.

b) të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë në pozicione të vlefshme, sipas përcaktimeve në shpalljen për pozicionin përkatës;

c) të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- Letërmotivimin për pozicionin;

- Jetëshkrimin (Cv-ne sipas shtojcës 11 të udhëzimit 14 dt. 27.05.2021.

- Kartën e identitetit;

- Diplomën;

- Librezën e punës;

- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;

- Certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;

- Vërtetimin e gjëndjes shëndetësore;

- Vërtetimin e gjëndjes gjyqësore;

- Vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij, nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi

- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara; Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së brenda dates 01/09/23 06.10..2023 .



Drejtori

Rudina Licaj